

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin**Shtator, 2021*

Grupe të shumta trajnimesh edhe gjatë gjithë shtatorit Punë e palodhshme e stafit qendror të SBASHK-ut



Edhe në muajin shtator koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK bashkë me stafin qendror kanë vazhduar me përkushtimin për të realizuar trajnimet për dhjetëra grupe mësimdhënësish bazuar në kërkesat e tyre që kanë ardhur përmes kryetarëve të nivelit komunal sindikal. Kështu ishte edhe në vikendin e 4 shtatorit kur shumë kolege e kolegë filluan me trajnimet "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar me trajnerin Hysen Sogojeva, "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social" me trajnerin Ramadan Gashi, pastaj trajnimi "Roli i aktiviteteve kreative në mësimdhënie dhe zbatimi i tyre në shkollat fillore" me ... (faqe 4)

Angazhime për të zbritur numrin e fëmijëve që braktisin shkollën

SBASHK përgatit kuadro që do të jenë në krye të këtij aktiviteti

Fatkeqësisht edhe në Kosovë, sikur në shumë vende të tjera, ende ka raste që një numër fëmijësh për arsye ... (faqe 9)

Intervistë me mësimdhënësen dhe trajneren Besjana Rexhepi



Mësimdhënia mision nga i cili varet e ardhmja e fëmijëve, por edhe e gjithë vendit... (faqe 3)

Takim me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve

Bashkëbisedë për fillimin e këtij viti shkollor



Lajmi se më në fund po fillon ky vit shkollor në ... (faqe 7)

U mbajtën Kuvende zgjedhore në Deçan e Kaçanik

Vlerësohet lart angazhimi i SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë



Duke realizuar agjendën e zgjedhjeve të nivelit ... (faqe 7)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Kolege e kolegë, anëtarë të SBASHK-ut, urime fillimi i vitit të ri shkollor



Pas dy shtyrjeve të arsyeshme për shkak të situatës tepër të rënduar nga pandemia, më 27 shtator filloi ky vit shkollor, që vlerësohet nga të gjithë se do të jetë i vështirë e me plot sfida. Stafi qendror i SBASHK-ut me respektin merituar iu drejtohet gjithë anëtarësisë kudo në Kosovë:

Të nderuar punëtorë të arsimit, kolege e kolegë, anëtarë të SBASHK-ut, urime fillimi i vitit të ri shkollor. Do jetë një

rrugëtim i vështirë ky në përpjekjet për realizimin e misionit tonë të shenjtë për arsimimin dhe edukimin e brezave, por ne edhe në të kaluarën jemi përballur me sfida dhe falë përkushtimit e gatishmërisë për sakrificatona sublime kemi bërë që drita të triumfojë dhe ta mund errësirën.

Ju falënderojmë që dëgjuat apelin e SBASHK-ut dhe u vaksinuat, ju përgëzojmë për gatishmërinë e treguar edhe para 1 shatorit për të nisur me vitin e ri shkollor dhe ju premtojmë se do të vazhdojmë të jemi zëri juaj, do të angazhohemi në shërbimin tuaj dhe do të bëjmë gjithë angazhimet për realizimin e kërkesave tuaja legjitime.

Suksese në vitin e ri shkollor. Sot e gjithmonë bashkë e në SBASHK.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me mësimdhënësen dhe trajneren Besjana Rexhepi

Mësimdhënia mision nga i cili varet e ardhmja e fëmijëve, por edhe e gjithë vendit



Besjana është mësimdhënëse në shkollën “Safet Rexhepi”, por edhe asistente në Universitetin publik “Kadri Zeka” në Gjiilan. Ka marrë pjesë në shumë tryeza e konferenca vendore e ndërkombëtare për arsimin.

Ajo është edhe autore e disa librave që në fokus kanë problematikat aktuale dhe reformimet e arsimit e deri te përpjekjet për të praktikuar të ashtuquajturën mësimdhënie bashkëkohore. Besjana është edhe trajnere në trajnimet e licencuara të SBASHK-ut.

Arsimimi sot:

Kush është Besjana Rexhepi ?

Besjana:

Quhem Besjana Rexhepi. Jam mësimdhënëse klasore në SHFMU “Safet Rexhepi” në rrethinë të komunës së Vitisë dhe njëherit asistente e lëndëve pedagogjike pranë Universitetit publik “Kadri Zeka” në Gjiilan. Që nga viti 2015 jam anëtare e SBASHK-ut dhe e përfshirë në një mori trajnimesh organizuar nga SBASHK, kryesisht në lokalitetin nga vij, por edhe aktive në konferenca e seminare të shumta si vendore dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë kryesisht me sferën e arsimit, më konkretisht me pedagogjinë, si fushë studimore e studimeve master dhe të doktoratës njëkohësisht. Njëherit jam autore edhe e disa librave që në fokus kanë problematikat aktuale dhe reformimet e arsimit, nisur nga të pretenduarit të të pasurit nxënësin në qendër të vëmendjes e deri te përpjekjet për të praktikuar të ashtuquajturën mësimdhënie bashkëkohore.

Arsimimi sot:

Si e vlerësoni profesionin e mësimdhënies ?

Besjana:

Duke e pasur parasysh se mësimdhënia është art në vete i të dhënit mësim që nuk mund të bëhet nga gjithkush, padyshim se ajo është mision nga i cili varet e ardhmja jo vetëm e fëmijëve, por edhe e gjithë

vendit. Sa më i përgatitur profesionalisht të jetë kadri i mësimdhënësve aq edhe më e suksesshme do të jetë mësimdhënia. Karshi kësaj sa më shumë investime dhe përkrahje në mësimdhënie aq dhe më shumë kuadro të denjë të profileve të tjera do të dalin. Prandaj dhe thuhet: “Janë shumë ata që mund të japin mësim, por janë pak ata që mund të quhen tamam mësimdhënës”.

Moria e trajnimeve që i ofron SBASHK-u ka një përkufizim të madh vlerash, pasi që jo vetëm anë administrative/institucionale për çështje licencimi që u mundëson mësimdhënësve, por dhe sofistikim njohurish për kategori të ndryshme të mësimdhënësve, sidomos për ata më në moshë që mund të mos jenë në rrjedha të mëdha rreth inovacioneve teknologjike që po bëhen në arsim, por dhe për të rinjtë, për të qenë sa më pro adaptimit praktik të teorive të mësuara qoftë nga studimet universitare, por edhe nga njohuritë që mund t’i marrin nga trajnimet.

Arsimimi sot:

Cila është vlera e trajnimeve që ofron SBASHK-u?

Besjana:

SBASHK-u është “OMBRELLA” e mësimdhënësve, që u gjendet në krah çdo kategorie të mësimdhënësve edhe me trajnime të lëmive të shumta edukativo-arsimore.

Arsimimi sot:

Si ndiheni në cilësinë e trajneres?

Besjana:

Të jesh trajnere është ndjesi e veçantë, pasi që kemi rolin e shumëfishtë, jo vetëm të ofruesit të njohurive, por edhe të bashkëpunimit me pjesëmarrësit, në rastin konkret me mësimdhënësit, duke mësuar edhe nga ta, qoftë nga përvojat e tyre, por edhe për sfidat që i hasin në procesin e mësimdhënies, apo edhe trajtimit të tyre institucional. Deri më tani kam pasur rastin të jem trajnere e 4 programeve si: “Angazhimi i burrave dhe grave në barazi gjinore”, nga organizata PEN, “Menaxhimi i stresit të nxënësit pas pandemisë

COVID-19” nga organizata EDUMEN, si dhe në 2 module trajnimi të SBASHK-ut si: “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social” dhe “Roli i mësimdhënësve për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës”. Në të gjitha këto do t’i veçoja trajnimet e SBASHK-ut si rrjedhojë e asaj që kemi pjesëmarrës të komunave të ndryshme dhe kemi mundësi gjithëpërfshirëse për të trajtuar tema të larmishme arsimore, por edhe për t’u munduar t’u japim zgjidhje çfarëdo lloj shqetësimi që mund të kenë mësimdhënësit, por dhe t’i tejkalojmë ato duke e mbështetur njëri tjetrin, jo vetëm nga tematikat e trajnimeve, por edhe nga praktikat e punës së tyre.

Arsimimi sot:

Me cilat çështje duhet të merret SBASHK?

Besjana:

Rrugëtimi i SBASHK-ut sado që ka qenë sfidues ka bërë që të jetë pranë çdo mësimdhënësi, duke mos lejuar paraprakisht cenimin e autoritetit të tij prej kujt qoftë, e posaçërisht larg politikës, që jo dhe rrallëherë ka bërë që ta njollosojë emrin mësimdhënësi,

por se SBASHK-u ka qenë gjithnjë pro mësimdhënësit pa e lejuar një tendencë të tillë injorante. SBASHK-u përveç intensifikimit edhe më të gjerë të trajnimeve në ato komuna ku ka më pak pjesëmarrës, mendoj se duhet të merret edhe me çështjen e adresimit të problemit të politizimit të shkollave, bashkë me mësimdhënësit në mënyrë që t’i kthehet dinjiteti i vërtetë mësimdhënësit e jo të jetë mësimdhënësi i deleguar nga direktivat politike komunale.

Arsimimi sot:

A keni ndonjë këshillë për kolegët tuaj kudo në Kosovë?


Besjana:

Këshillat e mia për çdo koleg mësimdhënësi janë që me çfarëdo problemi apo vështirësie që mund të përballen, ta bëjnë adresimin e tyre te SBASHK-u, si dhe të përfshihen sa më shumë në trajnimet e SBASHK-ut duke mos harruar anëtarësimin e tyre në SBASHK për të gjithë ata mësimdhënësi që nuk janë ende anëtarë të kësaj sindikate.

Gjatë muajit

Grupe të shumta trajnimesh edhe gjatë gjithë shatorit


Punë e palodhshme e stafit qendror të SBASHK-ut



Edhe në muajin shtator koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK bashkë me stafin qendror kanë vazhduar me përkushtimin për të realizuar trajnimet për dhjetëra grupe mësimdhënësisht bazuar në kërkesat e tyre që kanë ardhur përmes kryetarëve të nivelit komunal sindikal.

Kështu ishte edhe në vikendin e 4 shtatorit kur shumë kolege e kolegë filluan me trajnimet "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar me trajnerin Hysen Sogojeva, "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social" me trajnerin

Ramadan Gashi, pastaj trajnimi "Roli i aktiviteteve kreative në mësimdhënie dhe zbatimin e tyre në shkollat fillore" me trajneren Zahide Hamiti dhe trajnimi me prezencë fizike në Drenas "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie" me trajnerin Fejzullah Berisha për të vazhduar pastaj me trajnimet "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm" me trajneren - Pranvera Haziri dhe trajnimi "Roli i aktiviteteve kreative në mësimdhënie dhe zbatimin e tyre në shkollat fillore" me trajnerin Ahiret Mehmeti.




Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Edhe në vikendet tjera të këtij muaji është vazhduar të organizohet ky aktivitet. Vlen të përmenden edhe trajnimet e organizuar me koleget e kolegët tanë trajnimin “Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm” me trajnerë Pranvera Haziri, pastaj “Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik” me trajnerin Faton Ismajli, “Roli i aktiviteteve kreative në mësimdhënie dhe zbatimin e tyre në shkollat fillore”, që u udhëhoqën me sukses nga trajnerët Ahiret Mehmeti, Osman Rustemi, Lutfije Ibrahimit dhe Zahide Hamiti Krasniqi.



Janë mbajtur me sukses edhe trajnimet “Roli i aktiviteteve kreative në mësimdhënie dhe zbatimin e tyre në shkollat fillore” me trajneren Esengul Dinovci, “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social”, udhëhequr nga trajneri Blendor Shatri, trajnimi “Edukimi dhe menaxhimi mjedisor dhe zbatimin e tyre në shkollat fillore” me trajnerin Agim Hasani dhe trajnimi “Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar” me trajnerin Safet Beqiri.



Në këtë muaj kolegët tanë nga disa komuna janë angazhuar në trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”. Edhe trajnimi i licencuar rishtazi “Roli i mësimdhënësve për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës” u organizua me sukses gjatë muajit shtator.



Ky trajnim po mbahet me prezencë fizike në ambiente të institucioneve arsimore. Ky aktivitet është zhvilluar në shkollën “Tefik Çanga” të Ferizajt me trajneret Besjana Rexhepi e Myrvete Ramiqi dhe në shkollën “Mihal Grameno” në Fushë Kosovë, udhëhequr nga trajnerja Bukurije Krasniqi. Kryetari Rahman Jasharaj bashkë me koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri të shoqëruar nga kryetari i Kuvendit të Arsimit Parauniversitar për komën e Ferizajt Fejzullah Vranovci dhe kryetari i nderit për këtë komunë e veprimtari sindikal Rexhep Sadiku kanë vizituar pjesëmarrësit e këtij aktiviteti dhe kanë zhvilluar bashkëbisedë në një atmosferë përkushtimi e respekti të ndërsjellë.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Pjesëmarrësit e këtij aktiviteti kanë shprehur respekt meritor për angazhimet e SBASHK-ut dhe kanë bërë edhe pyetje të shumta në të cilat është përgjigjur koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri.

Pas kësaj kryetari Jasharaj, nënkryetarja Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë vizituar edhe pjesëmarrësit e trajnimit në shkollën “Mihal Grameno” dhe kanë zhvilluar bashkëbisedë me ta.



Kryetari Jasharaj ka komunikuar edhe me trajneren Dinovci dhe me kolegët tanë të komunitetit turk duke përgëzuar ata për vullnetin e treguar që të jenë pjesë e këtij aktiviteti të SBASHK-ut. Ai ka përgëzuar në veçanti trajneren dhe veprimtaren sindikale Esengul Dinovci, e cila me punë e përkushtim ka ndihmuar që ky aktivitet të zhvillohet edhe për kolegët tanë të komunitetit turk.



Teksa trajnimet po vazhdojnë me rrjedhë të mbarë koordinatori për organizim të brendshëm bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala e zyrtaren Vlora Rexhepi Berisha janë duke realizuar në tërësi kërkesat e trajnimit “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, që parashohin që pas çdo moduli të përfunduar pjesëmarrësit të dëshmojnë arritjet dhe njohuritë e fituara përmes testit të njohurive.




Ky aktivitet është zhvilluar me koleget e kolegët tanë nga Lipjani, Malisheva dhe Drenasi.



Takim me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve

Bashkëbisedë për fillimin e këtij viti shkollor

Lajmi se më në fund po fillon ky vit shkollor në institucione arsimore, ka gëzuar të gjithë punëtorët arsimor. Për të bërë një vlerësim të rrjedhës së procesit mësimor, SBASHK ka mbajtur në orët e mbrëmjes së 27 shtatorit një takim nga larg me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve.



Në fillim të këtij takimi kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka përgëzuar pjesëmarrësit dhe gjithë kolegët kudo janë për fillimin e këtij viti shkollor e pastaj ka informuar ata për disa prej aktiviteteve sindikale. Ai ka treguar se SBASHK në çdo takim me institucionet dhe në paraqitjet publike përmes medieve ka insistuar që të bëhet një zgjidhje e pranueshme për punëtorët arsimor me sëmundje të rënda dhe në kuadër të këtij angazhimi SBASHK i është drejtuar edhe Kryeministrit Kurti me kërkesën që Qeveria e Kosovës ta vë në rend dite këtë çështje dhe të sjell vendim që punëtorët arsimor me sëmundje të rënda të lirohen nga obligimi për të shkuar në punë,

të mbesin në listat e pagave dhe në vend të tyre të angazhohen kuadro të reja.

Pas kësaj koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri ka dhënë detaje lidhur me rrjedhën e trajnimeve duke theksuar se vazhdon të jetë interesim i madh i mësimdhënësve për pjesëmarrje në këtë aktivitet dhe se janë duke u bërë angazhime, që me t'u krijuar kushtet, trajnimet të mbahen në ambiente të institucioneve arsimore. Në vazhdim të takimit pjesëmarrësit kanë dhënë vlerësime lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor në komunat e tyre duke u shprehur se ishte një fillim i suksesshëm dhe se punëtorët arsimor do të angazhohen me përkushtim për rrjedhën e mbarë të vitit të ri shkollor.



Pas kësaj është bashkëbiseduar edhe për Kongresin e BSPK-së, që mbahet të shtunën e 2 tetorit dhe ishte mendim i përbashkët që të mbahet një takim konsultativ me delegatët e SBASHK-ut për të bashkëbiseduar për gjithë çështjet që mund të debatohen gjatë punimeve të këtij Kongresi.

U mbajtën Kuvende zgjedhore në Deçan e Kaçanik

Vlerësohet lart angazhimi i SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë



Duke realizuar agjendën e zgjedhjeve të nivelit komunal sindikal janë mbajtur Kuvende zgjedhore në Deçan më 4 shtator, ndërsa më 9 shtator në Kaçanik.

Në Deçan pjesëmarrësit janë gjendur në ambientet e Gjimnazit “Vëllezërit Frashëri” për të kryer procesin zgjedhor, për të debatuar për angazhimet në katër vitet e kaluar dhe për të propozuar ide për angazhimet në vijim.

Kryetari i këtij Kuvendi Burim Avdijaj në hapje të këtij takimi ka mbajtur një fjalë rasti duke

përrshëndetur e falënderuar për pjesëmarrje kryetarin e SBASHK-ut Rahman Jasharaj , drejtorin e Drejtorisë për Arsim të Deçanit , Bekim Vishaj , zyrtarin ligjor në SBASHK, Blendor Shatri e duke falënderuar edhe drejtorinë e kësaj vatre arsimore për mikpritjen.

Në fjalën përrshëndetëse kryetari Jasharaj ka përgëzuar gjithë kolegët në Deçan për angazhimin e unitetin, që treguan edhe në ditë të vështira e plot sfida të grevës, por edhe gjatë gjithë këtyre viteve. Ai ka lavdëruar edhe drejtorin e DK-së, z.Vshaj, i cili gjithmonë ka qenë korrekt në bashkëpunimin e sindikatën në nivel komunal.



Drejtori i DKA-së për këtë komunë, z.Vishaj ka përrshëndetur pjesëmarrësit e këtij takimi zgjedhor duke lavdëruar bashkëpunimin korrekt me sindikatën në nivel komunal, edhe atëherë kur kanë pasur qasje të ndryshme për çështjet aktuale, si tha ai. Ai ka përrshëndetur kryetarin Jasharaj duke shtuar se ai është i mirëseardhur çdo herë në Deçan dhe se gëzon respekt meritor. Drejtori Vishaj i ka përcjellë pjesëmarrësve përrshëndetjet nga kryetari i Deçanit z.Ramosaj. Pas kësaj kryetari i këtij Kuvendi Avdijaj ka prezantuar para pjesëmarrësve raportin e punës dhe atë financiar, të cilët njëzëri janë aprovuar nga pjesëmarrësit e këtij takimi.

Para se të kalohej në pjesën e dytë të këtij Kuvendi zgjedhor, zyrtari ligjor i SBASHK-ut, Blendor Shatri ka dhënë sqarimet e nevojshme lidhur me çështjet statutare që lidhën me procesin zgjedhor. Pas kësaj është kaluar në procesin zgjedhor dhe në garën mes dy e më shumë kandidatëve janë zgjedhor organet udhëheqëse të këtij kuvendi dhe përfaqësuesit e këtij kuvendi në Këshillin Drejtues dhe delegatët për Kongresin e radhës.

Pas numërimit të votave është konstatuar se kryetar është rizgjedhur Burim Avdijaj, ndërsa nënkryetare Mervedia Lulaj. Po ashtu përmes votës së fshehtë janë zgjedhur edhe anëtarët e kryesisë dhe përfaqësuesit tjerë në organet gjegjëse të SBASHK-ut nga kjo komunë.

Kryetari Avdijaj është falënderuar për besimin e dhënë duke premtuar se me kryesinë do të angazhohet edhe në të ardhmen për të zhvilluar aktivitete në shërbim të anëtarësisë, i bindur se, si deri tani, edhe në të ardhmen do ta ketë mbështetjen dhe përkrahjen e stafit qendror të SBASHK-ut.

Pjesëmarrësit e këtij Kuvendi duke vlerësuar lart angazhimin, përkushtimin dhe prezantimin dinjitoz të kërkesave të anëtarësisë për vite me radhë kanë propozuar që Rahman Jasharaj të zgjidhet edhe për një mandat kryetar i SBASHK-ut.

Atmosferë pune e përkushtimi ishte edhe më 9 shtator në ambientet e Gjinnazit “Skënderbeu” të Kaçanikut, që shquhet për arritje të larta në arsimimin dhe edukimin e brezave të kësaj ane, është mbajtur Kuvendi zgjedhor i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë. Kryetari i këtij Kuvendi Fevzi Bunjaku në hapje të takimit zgjedhor, ka përrshëndetur kryetarin e SBASHK-ut Rahman Jasharaj, koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe nënkryetarin e BSPK-së, prof. dr. Atdhe Hykolli, i cili ka përcjellë përrshëndetjet nga stafi qendror i kësaj Konfederate dhe është shprehur krenar me përkushtimin dhe arritjet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë, që është bërë siç tha ai, shembulli më i mirë i një organizimi të mirëfilltë sindikal.



Duke përrshëndetur të pranishmit kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj ka shprehur respekt meritor për kryetarin Bunjaku, kryesinë dhe veprimtarët tjerë sindikal nga kjo komunë për angazhimet e vazhdueshme në shërbim të anëtarësisë dhe realizimin e kërkesave të tyre. ”Jam ndjerë i nderuar e krenar që angazhohem bashkë me Fevziun ,me kryetarët tjerë të nivelit komunal e të Universiteteve në misionin tonë sindikal për realizimin e kërkesave legjitime të

anëtarësisë. Falënderoj anëtarësinë kudo në Kosovë për unitetin dhe mbështetjen e vazhdueshme që na kanë dhënë në rrugëtimin për të realizimin e objektivave dhe detyrave që kanë dhënë organet udhëheqëse të SBASHK-ut. Jam krenar që ndodhemi në këtë institucion arsimor, i cili ka shënuar arritje të mëdha në edukimin e arsimimin e brezave”, është shprehur Jasharaj.



Pas kësaj koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri ka dhënë sqarime lidhur me ecurinë e procesit zgjedhor duke u përgjigjur edhe në pyetjet e pjesëmarrësve. Punimet Kuvendi i ka vazhduar me prezantimin nga kryetari Bunjaku të raportit të punës dhe atij financiar, të cilët janë aprovuar nga pjesëmarrësit e këtij Kuvendi, të cilët kanë shprehur përgëzime për angazhimet e arritjet në nivel komunal e qendror të SBASHK-ut. Në pjesën e dytë të punimeve të këtij Kuvendi është filluar me procesin zgjedhor, që është mbajtur përmes votës së fshehtë në

garën mes dy e më shumë kandidatëve për secilin funksion sindikal. Ky Kuvend duke vlerësuar e çmuar angazhimin dhe kontributin e kryetarit Bunjaku i ka dhënë besimin edhe për një mandat, ndërsa nënkryetare është zgjedhur Ester Mjaki. Po ashtu me votën e fshehtë e në një garë mes shumë kandidatëve janë zgjedhur edhe anëtarët e kryesisë së këtij Kuvendi, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, anëtarët e Komisionit mbikëqyrës dhe anëtarët e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut nga kjo komunë.



Kryetari Fevzi Bunjkau duke iu falënderuar anëtarëve të këtij Kuvendi është shprehur se edhe në ardhmen bashkë me kryesinë dhe gjithë koleget e kolegët do të angazhohen në realizimin e detyrave sindikale të sigurt se do ta kenë mbështetjen e plotë të stafit qendror dhe të gjithë anëtarësisë. Ai duke bërë publik mendimin e pjesëmarrësve dhe anëtarësisë ka thënë se ky Kuvend duke shprehur respekt meritore për punën dhe angazhimin e kryetarit Jasharaj e kandidon atë edhe për një mandat që të udhëheq SBASHK-un drejt arritjeve e sukseseve të reja.

Angazhime për të zbritur numrin e fëmijëve që braktisin shkollën

SBASHK përgatit kuadro që do të jenë në krye të këtij aktiviteti

Fatkeqësisht edhe në Kosovë, sikur në shumë vende të tjera, ende ka raste që një numër fëmijësh për arsye të gjendjes ekonomike a për arsye të tjera, braktisin shkollën dhe fillojnë të angazhohen në punë, disa prej të cilave janë të rënda dhe shkaktojnë pasoja për shëndetin dhe personalitetin e këtyre fëmijëve. SBASHK ka ngritur këtë shqetësim vazhdimisht dhe në përpjekje për të dhënë kontribut konkret e ka paraparë edhe në Kontratën Kolektive angazhimin që do të bëhet në bashkëpunim me ILO-n, EI-në dhe sindikatat simotra për të shënuar arritje në këtë aktivitet. Duke u nisur nga kjo SBASHK-u në bashkëpunim me përfaqësuesen e Organizatës Botërore të Punës për Kosovën kishte nisur me

mbajtjen e punëtorisë për përgatitjen e kuadrove, që në cilësinë e trajnerit do të angazhoheshin me trajnimin “Roli i mësimdhënësve në mbrojtjen e fëmijëve nga format e rënda të punës” duke bartur njohuritë dhe mesazhin e këtij aktiviteti edhe te përfaqësues të të gjitha institucioneve arsimore të Kosovës për të krijuar kështu një front të gjerë të angazhimeve për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe të punësuarve të rënda e të rrezikshme për fëmijët. SBASHK pas kësaj bëri gjithë angazhimet dhe arriti ta licencojë këtë trajnim në Këshillin Shtetëror të Licencimit të Mësimdhënësve e pastaj organizoi edhe një punëtori me trajnerët për të përgatitur ata sa më mirë për detyrën e tyre prej trajneri.



Në fillimet e këtij aktiviteti kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka përgëzuar koleget e kolegët, që kanë kryer me sukses trajnimin për ta që është mbajtur për tri ditë me radhë duke u shprehur i sigurt se ata do të jenë në nivel të lartë të detyrës në cilësinë e trajnerëve dhe do të bartin gjithë njohuritë e fituara për rolin i mësimdhënësve në mbrojtjen e fëmijëve nga format e rënda të punës te kolegët e tyre kudo në Kosovë. Ai ka shprehur respekt meritore për koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe stafin qendror për angazhimin maksimal në detyrat e përditshme, por edhe për kontributin e lartë për rrjedhën e mbarë të tetë trajnimeve të licencuara të SBASHK-ut.



Nënkryetarja Vjollca Shala ka bërë një shpalosje të aktivitetit tre ditor me pjesëmarrësit dhe u ka uruar atyre suksese në detyrën shumë të rëndësishme të trajnerit, kurse koordinatori i Ymeri u ka treguar trajnerëve të ardhshëm të trajnimit “Roli i mësimdhënësve në mbrojtjen e fëmijëve nga format e rënda të punës” për detyrat konkrete dhe angazhimet që duhet bërë për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti. Ai u ka treguar pjesëmarrësve të këtij aktiviteti se në ditët në vijim në koordinim edhe me kryetarët e nivelit komunal do të krijohen grupet e para dhe do të niset edhe me këtë trajnim, që ka vlerë dhe domethënie të veçantë dhe dëshmon për edhe një përpjekje dhe kontribut me vlerë të SBASHK-ut në shërbim të arsimit. Trajnerët janë ndjerë të nderuar që SBASHK-u u ka besuar këtë detyrë dhe kanë premtuar angazhim e përkushtim në arritjen e gjithë objektivave të këtij aktiviteti.

SBASHK informon EI-në dhe ETUCE-n për situatën aktuale në arsim

Shumë angazhime në shërbim të arsimit dhe anëtarësisë



Stafi qendror i Internacionales së Arsimit (EI) dhe ai i Komitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE) gjithë kohës kanë organizuar takime e aktivitete të shumta përmes platformave gjegjëse me gjithë sindikatat anëtare duke shprehur mbështetjen e duke u dhënë kurajë e këshilla për angazhime të vazhdueshme në misionin e shenjtë të edukimit të brezave dhe për aktivitete sindikale në shërbim të anëtarësisë në kushtet e rënduara të punës e aktivitetit shkaktuar nga pandemia.

Duke shprehur respektin për gjithë këtë angazhim dhe për t'i informuar me kohë për gjendjen në arsimin e Kosovës, përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë marrë pjesë në gjithë këto aktivitete të organizuara nga EI dhe ETUCE. Po ashtu stafi qendror përmes shkresave ka informuar ata lidhur me sfidat, angazhimet dhe arritjet e sindikatës sonë. Një informatë të tillë SBASHK-u i ka dërguar atyre edhe më 29 shtator. Në këtë informatë thuhet:

I nderuari sekretar i përgjithshëm i EI-së, z. Edvards E nderuara drejtore e ETUCE-së për Evropë, znj. Flocken

“Duke shprehur edhe një herë falënderimin dhe respektin e singertë të të gjithë anëtarësisë së

SBASHK-ut për angazhimet tuaja në shërbim të sindikalizmit dhe arsimit kudo në Evropë e botë dhe për përkrahjen e vazhdueshme për SBASHK-un, e shohim të arsyeshme që t'ju mbajmë të informuar për situatën aktuale në arsimim në shtetin tonë dhe për disa nga aktivitetet kryesore sindikale të SBASHK-ut në shërbim të arsimit dhe të anëtarësisë sonë. Të nderuar, këtë vit, përveç pesë trajnimeve të licencuara, e që i kemi ri-licencuar, kemi arritur të licencojmë edhe tri trajnime të tjera, të cilat u shërbejnë mësimdhënësve për marrjen e njohurive të reja në shërbim të ngritjes së cilësisë në arsim dhe për t'u pajisur me certifikata, që u kërkohen për licencat e punës dhe në të ardhmen edhe për gradime.

Ju informojmë se viti i ri shkollor është dashur të nis më 1 shtator, por në Kosovë kishim një situatë tepër të rënduar, veçmas nga varianti Delta dhe prandaj Institucionet në bashkëpunim me SBASHK-un kishin vendosur të bënin dy shtyrje të vitit shkollor. Është lajm i gëzuar për të gjithë ne se viti shkollor filloi më 27 shtator, falë angazhimit e përkushtimit të punëtorëve arsimor dhe të tjerëve dhe falë faktit se kemi përmirësim të dukshëm të gjendjes nga pandemia dhe rënie të madhe të numrit të të infektuarve. Mësimi filloi në të gjitha shkollat e Kosovës me 20 nxënës në paralele, kurse në paralelet me më shumë nxënës ato janë ndarë në dy grupe me orë më të shkurtra, gjegjësisht me orët 30 minuta e ka raste edhe kur punohet me versionin e kombinuar 20 nxënës në klasë dhe të tjerët në mësim nga larg. Vlen të theksojmë se me angazhimin dhe presionin e SBASHK-ut institucionet i kishin vënë në prioritet punëtorët arsimor për vaksinim, por në fillim ndodhi të ketë edhe hezitim, por SBASHK-u doli me apel publik për vaksinim duke dhënë shembull të mirë faktin se stafi qendror i SBASHK-ut ishte nga të parët që janë vaksinuar. Punëtorët arsimor e kanë dëgjuar apelin tonë dhe tani kemi rreth 95 % të punëtorëve arsimor të vaksinuar.

Ne si SBASHK tërë aktivitetin e deri tashëm e kemi orientuar për fillim të mbarë të vitit shkollor e njëkohësisht kemi mbajtur trajnime me qindra mësimdhënës në shërbim të ngritjes së performancës së tyre.

Ju informojmë se në disa nga komunat është filluar me implemtimin e pjesëve të Kontratës Kolektive, siç është rasti me lirin e kryetarëve të nivelit komunal

që të punojnë me gjysmë norme në arsim, e gjysmë norme të angazhohen në aktivitete sindikale e duke u paguar me pagë të plotë, kurse kryetarët e shoqatave lirohen për dy orë mësimore në shërbim të aktivitetit sindikal dhe marrin pagë të plotë. Jemi në angazhime të vazhdueshme që këtë ta realizojmë edhe në komunat tjera.

Po ashtu ju informojmë se përfaqësuesit e SBASHK-ut janë aktiv dhe po japin kontribut në të gjitha komisionet e ngritura nga MASHTI, qoftë në strategjitë për arsimin, qoftë në task forcën e arsimit për menaxhimin e pandemisë e ky angazhim vërehet edhe në nivelin lokal.

Një çështje tjetër për të cilën ndjejmë nevojë t'ju informojmë, e besojmë se është lajm i gëzuar për ju, është se Konfederata e Sindikatave të Kosovës, (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës), e mbanë Kongresin zgjedhor më 2 tetor 2021 dhe SBASHK ka kandiduar për kryetar të kësaj Konfederate kolegun tonë prof.dr. Atdhe Hykolli dhe për të kemi marrë mbështetje edhe nga Federatat tjera, si nga Federata e shërbyesve civil të Kosovës, Federata e Policisë së Kosovës, Federata e Energjetikës së Kosovës, Federata e Ndërtimtarisë dhe federatat tjera. Kështu që më datën 2 tetor jemi të sigurt se ky përfaqësues i SBASHK-ut të zgjidhet kryetar i kësaj Konfederate, që është e vetmja si e tillë në Kosovë. Kjo është një përpjekje e SBASHK-ut që ndikimin që e kemi në rrjedhat sindikale ta shtrijmë edhe në Federatat tjera dhe në vetë Konfederatën.

Ky është një përshkrim i shkurtër i gjendjes aktuale dhe i disa prej angazhimeve tona sa për informimin tuaj dhe shfrytëzojmë rastin të falënderojmë EI-në e në veçanti Juve i nderuari sekretar i përgjithshëm dhe ETUCE-n e në veçanti Juve e nderuara drejtore për mbështetjen që vazhdimisht i keni dhënë SBASHK-ut. Edhe në këtë rast shprehim dëshirën që sekretari i përgjithshëm i EI z.Edvards bashkë me kryetarin e ETUCE z.Flangan dhe drejtoresha znj.Flocken të marrin pjesë në Kongresin e SBASHK-ut, i cili planifikohet të mbahet në muajin mars ose prill 2022, varësisht nga datat që do të koordinoheshim me ju e me dëshirën e vetme që edhe ju të jeni pjesëmarrës shumë të nderuar në këtë ngjarje të veçantë për sindikatën tonë”, ka informuar SBASHK EI-në dhe ETUCE-n.